



Intervistë me Prof. Dr. Ibrahim Gashin, nënkryetar i Aleancës së Re të Kosovës (ARK)

1. z.Gashi, Aleanca Kosova e Re (AKR) është edhe subjekti më i ri politik në Kosovë. Kosova ka mjaft parti politike. Pse u desh krijimi edhe i një partie të re?

Krijimi i Partisë Aleanca Kosova e Re vjen pikërisht në një kohë kur Kosova po kalon nëpër një periudhë vendimtare të historisë së saj, atë të definimit të statusit politik dhe krijimit të shtetit të Kosovës. Në rrethana të tilla kur faktorët vendimmarrës ndërkombëtar po hezitojnë për të mnos thenë po përballën më dilëmen se sa shteti i ardhshëm i Kosovës do të jetë i aftë të mbijetoj politikisht dhe ekonomikisht ideja për krijimin e AKR-së vie pikërisht si alternativë për të qartësuar këto dilema. Pra vie si altertativë e krijimit të nje qendrueshmeri ekonomike të shtetit të ardhshëm të Kosovës në një kohë kur partitë aktuale dhe sidomos ato në pushtet nuk e kanë krijuar këtë besueshmeri.

2. Cila është shtrirja dhe organizimi aktual i AKR-së?

AKR, pas mbajtjes së Kuvendit të Përgjithshëm (24.10.2006) ka krijuar organet e saj drejtuese: Këshillin Drejtues, Kryesinë, Kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarët (të përgjithshëm dhe organizativ). Është dukë u punuar në strukturimin e saj në nivelin e degëve dhe të nëndegëve. Në Kuvendin e Forumit të Gruas (24.11.2006) është zgjedhur Këshilli Drejtues, Kryesia dhe Kryetarëja e Forumit të Gruas.

3. Dihet se në Ballkan partitë ngriten zakonisht gjatë proceseve të rëndësishme historike të një populli. Partia juaj pretendon të marrë shumicën e votave në zgjedhjet e ardhshme në vend, ndërsa nuk është as pjesë e Ekipit Negociator për definimin e statusit të Kosovës. A i frikësoheni zhgënjimit pas publikimit të rezultatit të zgjedhjeve?

Secila nga partitë, qoftë egzistueset, qoftë të sapokrijuarat kanë për synim marrjen e pushtetit. Përseri secila ka një mekanizem të brendshëm më të cilin i konstaton gjasat dhe një startegji të saj politike për të arritur objektivat e saj. Dilema juaj se ne nuk kemi prespektivë si parti, pse nuk kemi qene pjese e Grupit Negociator, mendoj se nuk ka vend. Une pikërisht mendoj të kundërtën. Se derisa një pjesë e politikës ka kthyer sytë nga ne na bënë që të ndjehemi si forcë politike potenciale në garen për pushtet. Ne e kemi thënë më se një herë se nuk pretendojmë të marrim as meriten por as fajin e atyre qe kanë qene pjesë e Ekipit Negociator. Ne si forcë politike jemi krijuar kur procesi i definimit te statusit ka hyre ne fazen finale.

4. Elektorati i LDK-së është ndier i zhgënjyer me udhëheqësit e tij gjatë dhe pas Kuvendit VI Zgjedhor. Analistët kanë paraparë rënie drastike të kësaj partie në të ardhmen. Pra, ju keni vënë shpresat në një pjesë të elektoratit të LDK-së?

Ne nuk gëzohemi, siç thot populli, në fatkeqsinë e tjetrit. Për ne anëtar potencial të AKR-së janë të gjithë qytetarët e Kosovës që besojnë në programin dhe vizionin tonë. Ne jemi të hapur për të gjithë.

5. Me cilën parti në Kosovë jeni më të afërt aktualisht?

Ne si parti e re do të dëshmojmë më punën dhe sjelljen tonë se do të jemi të afertë më të gjitha ato parti që kanë përkushtim serioz Kosovën dhe interesat e qytetarëve të saj. Duke qenë se jemi në fillim të aktivitetit tonë kemi preferenca të njejta për të gjitha partitë aktuale. Pra jemi të hapur për të gjithë për çfardo forme të bashkëpunimit që është në të mirën e qytetarit të Kosovës.

6. z.Gashi, Kosova është në prag të definimit të statusit politik. Si e sheh AKR këtë proces?

Nga informacionet e bera publike deri ne kete fazë po dominon mendimi se do të kemi një zgjidhje graduale që do t'i hapë perspektivë krijimit të shtetit të Kosovës. AKR mendon se është më shumë rendësi që zgjidhja e propozuar të përmbaj si mesazh shume të qartë pavarësinë e Kosovës si zgjidhje përfundimtare. Në mendojmë se pavarësia është zgjidhje e balancuar për momentin që stabilizon Kosovën dhe Rajonin, dhe që hap prespektiven e integritit të Ballkanit



përendimor në UE dhe në NATO. Kjo zgjidhje (Kosova e pavarur) thellësisht besojmë se e ndihmon edhe vetë Serbinë që të shpejtoj procesin e integritetit të saj në mekanizma Euro-Atlantike.

7. Kryetari i partisë suaj, Behxhet Pacolli, ka thënë se do të angazhohet për sistem presidencial në Kosovë. A mendoni se i përshtatet Kosovës një sistem i tillë politik?

Ne besojmë se sistemi presidencial është zgjidhja më mirë për Kosovën që do të ngriste mekanizmin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies që aktualisht pothuaj nuk funksionon fare në Kosovë.

Musli Krasniqi - Infopress
044 405 383